



## GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QËNDRON NË MAJËN E E PIRAMIDËS GJYQËSORE. AJO SIGURON DHËNIEN E BARABARTË DHE TË PAANSHME TË DREJTËSISË PËR TË GJITHË QYTETARËT NË VEND DHE VENDOS STANDARDET E NJË GJYKIMI TË DREJTË. GJYKATA E LARTË E USHTRON PUSHTETIN NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET KUSHTETUESE DHE LIGJIN.

PARIMET THEMELORE QË E UDHËHEQIN GJYKATËN E LARTË NË VEPRIMTARINË E SAJ GJYQËSORE JANË: PAVARËSIA, PAANËSIA, EFIKASITETI, BARAZIA, DREJTËSIA, BESUESHMËRIA, LLOGARIDHËNIA DHE AKSESI TRANSPARENT NË DREJTËSI PËR TË GJITHË.

### GJYKATA E LARTË DHE PUBLIKU

Gjykata e Lartë luan një rol të veçantë në vendosjen e standartit se si gjyqësori ndan informacionin, komunikon me publikun dhe edukon qytetarët. Efektiviteti në dhënie të drejtësisë lidhet me aftësinë dhe gatishmërinë e gjykatës për të komunikuar mbi veprimtarinë e saj në një mënyrë të hapur, të vazhdueshme dhe të kuptueshme.

Rritja e transparencës dhe besimit të publikut qëndron në themel të të gjitha përpjekjeve të komunikimit të Gjykatës së Lartë. Informacioni vihet në dispozicion përmes një sërë kanalesh. Punonjësit e sekretarisë gjyqësore dhe Marrëdhëniet me Publikun u ofrojnë palëve të interesuara informacion mbi statusin e çështjeve të tyre gjyqësore. Orari i shqyrtimit të çështjeve afishohet çdo ditë në hyrje të gjykatës si edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Edhe përfaqësuesit e medias dhe anëtarët e tjerë të publikut kanë mundësinë që ta kontaktojnë Drejtorinë e Marrëdhëniet me Publikun, duke përdorur email-in ose llogaritë e mediave sociale.

Janë të ndryshme mënyrat se si publiku mund ta kontaktojë gjykatën, në varësi të nevojave për informacion.



# GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## PUBLIKU I GJERË:

Mund të jeni një student që po studion një temë që ka lidhje me Gjykatën e Lartë, ose jeni anëtar i shoqërisë civile, i interesuar mbi Programin e Transparencës së Gjykatës së Lartë, ose thjesht një individ që kërkon informacion. Në këto raste, mund të kontaktoni drejtpërdrejt me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun (Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, në hyrje të gjykatës), ose duke përdorur email-in apo llogaritë e mediave sociale.

## PËRFAQËSUESIT E MEDIAS

Të gjitha kërkesat e medias mbi cilëndo nga çështjet që lidhen me rolin dhe punën e Gjykatës së Lartë, apo çështjeve gjyqësore duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, duke përdorur email-in e përgjithshëm për kërkesat nga media: [media@gjykataelarte.gov.al](mailto:media@gjykataelarte.gov.al) ose mund të kontaktohet përmes llogarive zyrtare të Gjykatës së Lartë në Facebook dhe LinkedIn.

## KONTAKTONI GJYKATËN

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

-  Rr. Ibrahim Rugova Tiranë, Shqipëri
-  +355 4 2257304
-  [ida.vodica@gjykataelarte.gov.al](mailto:ida.vodica@gjykataelarte.gov.al)
-  [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)
-  <https://www.facebook.com/GjykataeLarte>
-  <https://www.linkedin.com/company/gjykata-e-lartë-e-republikës-së-shqipërisë/>